

FUNKSIONET DHE DETYRAT E UGJ

Në mbështetje të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti “Eqrem Cabej” Gjirokastrë, si një institucion i arsimit të lartë, që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale, ka këto funksione dhe detyra:

- ofron të gjitha nivelet e arsimit të lartë, që u korrespondojnë niveleve 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;
- përcakton karakteristikat dhe përmbajtjen e programeve të studimit;
- përcakton, zhvillon dhe konsolidon mënyrat e kontrollit të dijeve të studentëve sipas parimeve të meritës dhe paanshmërisë;
- nxit bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë;
- promovon procesin e zhvillimit, përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit, shërbimeve për territorin dhe komunitetin;
- mbështet prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;
- promovon kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar;
- siguron koordinimin dhe zhvillimin e projekteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- nxit përftimin e njohurive të përparuara shkencore dhe teknologjike; i jep vlerë ekspertizës dhe aftësive kërkimore në fusha të ndryshme;
- mbështet dhe mbron studentët në ushtrimin e së drejtës së tyre për arsim cilësor dhe siguron përfaqësimin e tyre si partnerë të plotë në qeverisjen e tij;
- promovon mirëkuptimin ndërkulturor, mendimin kritik, tolerancën politike dhe fetare, barazinë gjinore, vlerat demokratike dhe qytetare, në mënyrë që të forcojnë qytetarinë globale të studentëve, për të hedhur themele të një shoqërie gjithëpërfshirëse;

- promovon inovacionin në mësimdhënie ku në epiqendër është studenti, duke shfrytëzuar gjerësisht potencialin e teknologjive të reja;
 - ofron këshillim dhe monitoron zhvillimin e karrierës akademike të studentëve;
 - ofron shërbime për integrimin e të diplomuarve të saj në tregun e punës;
 - ndërmer nisma që synojnë krijimin e vendeve të reja për punë të kualifikuar; ruan lidhje me të diplomuarit e saj;
 - garanton zhvillimin e karrierës së personelit akademik, në respekt të lirisë akademike, meritës dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
- lëshon diploma dhe jep certifikata në përputhje me nivelin e formimit të kryer

SENATI AKADEMIK

Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë akademik i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij. Senati Akademik kryesohet nga Rektori dhe mbledhet periodikisht.

Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të personelit akademik, zgjidhen me shumicë votash nga asambltetë e personelit akademik të njësive kryesore përkatëse, për një mandate katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhje, midis anëtarëve të personeli akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar. Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve, zgjidhen nga studentët. Mund të jenë përfaqësues të studentëve vetëm ata shtetas që janë studentë të Universitetit “Eqrem Çabej” në çastin e zgjedhjes së tyre. Anëtarët e Senatit Akademik zgjidhen në përputhje me Rregulloren e Zgjedhjeve të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

ASAMBLEJA E PERSONELIT AKADEMIK

- Asambleja e personelit akademik (APA) përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore.
- APA-ja e njësisë kryesore ka këto funksione:
 - zgjedh rektorin e universitetit;
 - zgjedh anëtarët e Senatit Akademik;
 - zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore;
 - zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme të njësisë kryesore;
- Asambleja e personelit akademik organizohet dhe kryen veprimtarinë e saj sipas përcaktimeve në rregulloren e njësisë kryesore.

REKTORI

Rektori është autoriteti më i lartë akademik i UGJ-së. Është kryetar i SA-së, si dhe përfaqësuesi ligjor i UGJ-së për çështjet akademike dhe protokollare. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët;

Rektorati

- Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
 - Rektori;
 - Zëvendës Rektorët;
 - Administratori;
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore;

BORDI I ADMINISTRIMIT

Bordi i Administrimit i UGJ-së është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

ADMINISTRATORI

Administratori i UGJ-së është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i UGJ- së për çështjet financiare dhe administrative.